Vendim nr. 309, datë 30.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 30.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 23 (E) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **EDMOND LESKAJ,** përfaqësuar nga avokati Shaqir Hasanaj, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 183, datë 05.05.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 159 (87-2025-242), datë 09.07.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2026-89, datë 03.02.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**
Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe i parimit të barazisë përpara ligjit, të së drejtës së aksesit efektiv në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit gjyqësor.

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 27, 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, paragrafët 2 dhe 4, 6, paragrafi 3 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 6 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet**

27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

i. Procesi i parë (themeli)

1. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 69, datë 23.11.2009, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit të gjykuar në mungesë (*in absentia*) për kryerjen e veprave penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim, ndaj shtetasit B.D., duke e dënuar me 20 vjet burgim; pjesëmarrjes në bandën e armatosur, duke e dënuar me 8 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit S.K., duke e dënuar me 25 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit A.B., duke e dënuar me 25 vjet burgim; vrasjes me paramendim, të kryer ndaj shtetasit Z.H., duke e dënuar me 25 vjet burgim; vjedhjes me dhunë në dëm të shtetasit A.S., duke e dënuar me 25 vjet burgim; mbajtjes pa leje të armëve luftarake në kuadër të bandës së armatosur, duke e dënuar me 10 vjet burgim; në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal *(KP)*, kërkuesi është dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi është paraqitur apel nga palët e tjera në procesin penal.

2. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 37, datë 02.07.2010, ka lënë në fuqi vendimin nr. 69, datë 23.11.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda dhe të bashkëpandehurit e tjerë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1115 (48), datë 24.02.2014, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës së apelit, për sa u përket dy të bashkëpandehurve të tjerë, shtetasit A.S. dhe S.S., duke i deklaruar ata të pafajshëm për kryerjen e veprës penale "Pjesëmarrje në bandën e armatosur", ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pjesën tjetër.

4. Në datën 30.08.2008 kërkuesi është arrestuar në shtetin italian dhe në datën 09.01.2014 është ekstraduar në Shqipëri. Pasi është ekstraduar, ai ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur ankim ndaj vendimit penal nr. 69, datë 23.11.2009 të po asaj gjykate. Me vendimin nr. 12, datë 13.02.2014, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 6, datë 18.03.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 12, datë 13.02.2014 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3191, datë 22.12.2015, ka vendosur mospranimin e tij.

5. Në datën 21.06.2016 kërkuesi i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar vënien në dispozicion të dosjes së ekstradimit. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. A-536, datë 28.06.2016, ka refuzuar kërkesën, me arsyetimin se kërkuesi duhej t'i drejtohej gjykatës kompetente në lidhje me të. Pas paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ajo gjykatë, me vendimin nr. 891 (80-2017-889), datë 07.03.2017, ka vendosur detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë për t'i vënë në dispozicion informacionin e kërkuar kërkuesit dhe në datën 05.06.2017 dosja e ekstradimit është vënë në dispozicion të tij.

ii. Procesi i dytë (rishikimi i parë)

6. Në datën 29.08.2017 kërkuesi ka depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kërkesën për rishikimin e vendimit penal nr. 69, datë 23.11.2009, bazuar në nenin 51, pika 4, të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja" *(ligji nr.10193/2009)* dhe nenin 450/dh të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për shkak të gjykimit në mungesë dhe garancisë së shprehur nga Ministria e Drejtësisë se ndaj kërkuesit do të ofrohej mundësia për të rihapur edhe një herë procesin gjyqësor, nëse një kërkesë e tillë do të paraqitej prej tij.

7. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 228, datë 20.09.2017, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkesa nuk plotësonte kushtet ligjore, sipas nenit 450, shkronja "dh", të KPP-së dhe nenit 51, pika 4, të ligjit nr. 10193/2009, për sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës, i cili është 30 ditë nga mbërritja e të ekstraduarit në Shqipëri. Ekstradimi është kryer në datën 09.01.2014, ndërsa kërkesa për rishikimin e vendimit penal është paraqitur në datën 29.08.2017. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

8. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 115, datë 13.10.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Sipas gjykatës, është provuar fakti se kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin penal të dënimit të tij në momentin kur është ekstraduar nga autoritetet italiane në datën 09.01.2014. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-665, datë 09.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit, gjykatat kanë vlerësuar se kërkesa për rishikim nuk plotësonte kushtet ligjore të afatit të paraqitjes së saj në gjykatë, sipas nenit 450 të KPP-së. Po kështu, sipas Kolegjit Penal, kërkuesi nuk ka argumentuar nëse nga gjykatat më të ulëta nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural. Në përfundim, Kolegji Penal ka arsyetuar se nuk konstatohet që nga gjykata e apelit ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural penal me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, ose me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, apo se vendimi i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 07.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar si procesin e parë, atë të themelit, ashtu dhe procesin e dytë, atë të rishikimit. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 236, datë 16.10.2024 (*vendimi nr. 236/2024*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Sipas Kolegjit të Gjykatës, në lidhje me pretendimet për procesin e parë, atë të themelit, kërkuesi nuk legjitimohej, pasi kërkesa ishte paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, pasi ishte paraqitur pas rreth 10 vjetësh e dy muajsh nga vendimi i fundit që kishte mbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjetra të kërkuesit, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën e ankimit; të së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të ngritura në procesin e dytë, atë të rishikimit, Kolegji i Gjykatës i ka vlerësuar ato si haptazi të pabazuara.

iii. Procesi i tretë (rishikimi i dytë)

11. Ndërkohë, rezulton se në vitin 2025 kërkuesi i është drejtuar përsëri juridiksionit gjyqësor me kërkesën me objekt rishikimin e pjesshëm të vendimit nr. 69, datë 23.11.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për deklarimin të pafajshëm të tij për akuzën "Pjesëmarrja në bandën e armatosur", të parashikuar nga neni 333 i KP-së. Sipas kërkuesit, arsyetimi dhe disponimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1115 (48), datë 24.02.2014 (paragrafi 3 i relacionit), në lidhje me të bashkëpandehurit S.S. dhe A.S., që i ka deklaruar ata të pafajshëm për veprat penale për të cilat ishin dënuar më herët si të kryera në kuadër të bandës së armatosur, ka delegjitimuar konkluzionin për deklarimin fajtor dhe dënimin edhe të kërkuesit, në lidhje me akuzën për veprat penale "Krijimi i bandës së armatosur" dhe "Kryerja e krimeve nga banda e armatosur", sipas neneve 333 dhe 334 të KP-së (*sipas dispozitave në fuqi të kohës*).

12. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 183, datë 05.05.2025, ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e pjesshëm të vendimit nr. 69, datë 23.11.2009, si të pabazuar në ligj. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë në rastin objekt shqyrtimi nuk ndodhemi para dy vendimeve të ndryshme të formës së prerë (*ai që kërkohet të rishikohet dhe një vendim tjetër*) që përmbajnë fakte të ndryshme dhe të papajtueshme me njëri-tjetrin, por para rastit kur Gjykata më e Lartë, për të njëjtën çështje, ka arritur në konkluzione dhe vlerësime të ndryshme lidhur me fajësinë, për dy nga bashkëpandehurit e të njëjtit procedim/gjykim dhe ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nuk rezulton që në vendimin e saj Gjykata e Lartë të këtë arritur në përfundimin për mosekzistencën e veprave penale "Krijimi i bandës së armatosur" dhe "Kryerja e krimeve nga banda e armatosur", sipas neneve 333 dhe 334 të KP-së (*sipas dispozitave në fuqi të kohës*), në tërësinë e tyre (*në lidhje me faktet e çështjes*), por ka arsyetuar dhe konkluduar se nuk provohej pjesëmarrja e dy të gjykuarve (S.S. dhe A.S) në kryerjen e veprave penale nga banda e armatosur, duke arritur në përfundimin për pafajësinë e tyre në lidhje me të gjitha veprat penale për të cilat këta dy të pandehur ishin akuzuar dhe gjetur fajtorë se i kishin kryer si pjesëmarrës të bandës së armatosur. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, qartësisht Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar dhe është shprehur vetëm mbi faktet që lidhen me këta dy të pandehur dhe nuk është arritur në përfundimin për mosekzitencën e bandës së armatosur ose moskryerjen e veprave penale nga të pandehurit e tjerë në kuadër të kësaj forme bashkëpunimi, por është arsyetuar për mungesën e provueshmërisë të akuzave vetëm në lidhje me dy të gjykuarit në fjalë, A.S. dhe S.S., duke mos arritur në vlerësim të njëjtë edhe për të gjykuarin tjetër që kishte paraqitur rekurs, G.N. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit se vendimi i

dënimit të tij është dhënë si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor, nuk janë objekt vlerësimi në kuadër të kërkesës për rishikim, ndërsa pretendimet për zhvillimin e gjykimit në mungesë janë bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga gjykata që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afati të ankimit dhe kërkesën për rishikimin e vendimit bazuar në shkaqe të tjera ligjore. Ndaj vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë ka bërë ankim kërkuesi.

13. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 159 (87-2025-242), datë 09.07.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 183, datë 05.05.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, në rastin konkret nuk plotësohet kushti thelbësor për pranimin e kërkesës për rishikim, konkretisht ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë të cilat bazohen mbi fakte të ndryshme dhe të papajtueshme me njëri-tjetrin, sipas parashikimit të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 450 të KPP-së, që përbën edhe rastin e rishikimit në çështjen konkrete, dhe për këtë arsye arsyetimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është i drejtë. Në këtë kuptim, edhe GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se në këtë rast nuk ndodhemi para dy vendimeve të ndryshme të formës së prerë (ai që kërkohet të rishikohet dhe një vendim tjetër) në themel të të cilave qëndrojnë fakte të ndryshme dhe të papajtueshme me njëri-tjetrin, por para rastit kur gjykata më e lartë, për të njëjtën çështje, ka arritur në konkluzione dhe vlerësime të ndryshme nga gjykatat e faktit vetëm në lidhje me fajësinë për dy nga të bashkëpandehurit në të njëjtin procedim/gjykim me kërkuesin. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit, referuar arsyetimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nuk është arritur në përfundimin për mosekzistencën e faktit penal të bandës së armatosur ose moskryerjen e veprave penale nga të pandehurit e tjerë (anëtarë të kësaj bande të armatosur) në kuadër të kësaj forme bashkëpunimi, por është konkluduar për mungesë të provueshmërisë së akuzave vetëm në lidhje me dy prej të gjykuarve, duke mos arritur në vlerësim të njëjtë edhe për të gjykuarin tjetër që kishte paraqitur rekurs, G.N. Për sa u përket pretendimeve për parregullsitë procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit në themel të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit ose çmuarjes së provave, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se ato nuk i përkasin kësaj faze gjykimi, objekti i së cilës janë kushtet e pranueshmërisë së kërkesës për rishikim. Ndërsa në lidhje me pretendimet e kërkuesit për zhvillimin e gjykimit në mungesë, sipas GJKKO-së së Apelit ato kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga gjykatat që kanë shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat të ankimit dhe kërkesën për rishikimin e vendimit bazuar në shkaqe të tjera ligjore. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-89, datë 03.02.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga

neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi janë parashtruar edhe në mjetin procedural "ankim" dhe janë marrë në shqyrtim gjerësisht nga GJKKO-ja e Apelit dhe vendimmarrja e kësaj të fundit është e mirëarsyetuar, duke marrë në shqyrtim dhe duke u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykatat më të ulëta kanë marrë në shqyrtim edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me procesin e rregullt ligjor ose vlerësimin e provave, duke arritur në përfundimin se këto pretendime nuk përbëjnë shkak për rishikimin e vendimit.

15. Në datën 02.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

16. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

17. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

17.1. Është cenuar *e drejta e askesit efektiv dhe e drejta e mbrojtjes*, pasi procedimi penal dhe gjykimi i kërkuesit janë zhvilluar në mungesë të tij. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se gjykatat kanë konstatuar "mosgjetje" të kërkuesit, ndërkohë që autoritetet shtetërore kishin dijeni të plotë për vendndodhjen e kërkuesit, pasi ishte i arrestuar në Itali dhe ndodhej në procedurë ekstradimi. Kërkuesi nuk është njoftuar në mënyrë reale dhe efektive për gjykimin në themel dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, duke mosushtruar në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes.

17.2. Është cenuar *parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit,* pasi për të njëjtin kuadër faktik, të njëjtën strukturë të pretenduar kriminale dhe të njëjtat episode penale, gjykatat kanë arritur në përfundime të ndryshme për disa të bashkëpandehur të tjerë, pa asnjë arsyetim objektiv, të arsyeshëm dhe të individualizuar në këtë drejtim.

17.3. Është cenuar *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje substanciale çështjes thelbësore të kërkuesit në lidhje me pretendimin sesi është e mundur që për të njëjtat fakte dhe të njëjtin kompleks kriminal disa të bashkëpandehur të shpallen të pafajshëm për veprën penale

"Pjesëmarrja në bandë të armatosur", ndërsa kërkuesi të mbetet fajtor. Gjykatat janë kufizuar në konstatime formale për mosplotësimin e kushteve ligjore për kërkesën për rishikim, pa adresuar kontradiktën objektive në vlerësimin juridik të të njëjtit kompleks faktesh.

17.4. Interpretimi formalist që i kanë bërë gjykatat nenit 450 të KPP-së ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së kërkuesit për rishikim. Në rastin konkret ekziston një vendim i Gjykatës së Lartë që për të njëjtin kuadër faktik dhe të njëjtin procedim penal ka përjashtuar disa të bashkëpandehur nga përgjegjësia penale për kryerjen e veprës penale "Pjesëmarrja në bandë të armatosur". Gjykatat kanë refuzuar të analizojnë përmbajtjen substanciale të kësaj papajtueshmërie dhe janë kufizuar në një interpretim thjesht formal, duke mos hyrë në thelbin e kontradiktës juridike. Gjykatat e kanë interpretuar në mënyrë të ngushtë nenin 450 të KPP-së.

17.5. Pas ekstradimit kërkuesit nuk i është respektuar garancia që ka dhënë shteti shqiptar për zhvillimin ndaj tij të një procesi të rregullt ligjor, për mundësinë efektive për të ushtruar mjetet e ankimit dhe për të kërkuar rigjykimin. Kërkesat e tij për rishikim janë trajtuar në mënyrë formale, pa një analizë të plotë të mungesës së njoftimit efektiv dhe të faktit të gjykimit në mungesë.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet

plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

20. Në lidhje me legjitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit, në thelb lidhen me procesin e parë të zhvilluar ndaj tij, atë të themelit, në të cilin ai është deklaruar fajtor për kryerjen e disa veprave penale. Sipas kërkuesit, është cenuar e drejta e *aksesit efektiv, e drejta e mbrojtjes, parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, si dhe *standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Në mbështetje të këtyre pretendimeve kërkuesi ka argumentuar se procedimi penal dhe gjykimi i tij janë zhvilluar në mungesë të tij dhe ai nuk është njoftuar në mënyrë reale dhe efektive për gjykimin në themel; për të njëjtin kuadër faktik, të njëjtën strukturë të pretenduar kriminale dhe të njëjtat episode penale, gjykatat kanë arritur në përfundime të ndryshme për disa të bashkëpandehur të tjerë, pa asnjë arsyetim objektiv, të arsyeshëm dhe të individualizuar në këtë drejtim; gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje substanciale çështjes thelbësore të kërkuesit dhe janë kufizuar në konstatime formale për mosplotësimin e kushteve ligjore për kërkesën për rishikim, pa adresuar kontradiktën objektive në vlerësimin juridik të të njëjtit kompleks faktesh; gjykatat kanë bërë një interpretim formalist të nenit 450 të KPP-së, i cili ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së kërkuesit për rishikim; kërkesat e tij për rishikim janë trajtuar në mënyrë formale, pa një analizë të plotë të mungesës së njoftimit efektiv dhe të faktit të gjykimit në mungesë.

21. Fillimisht, Kolegji rithekson faktin se në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të vendimit penal, individët nuk mund të pretendojnë të parashtrojnë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes, duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor, si mjet i jashtëzakonshëm i ankimit, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj (*shih vendimin nr. 236, datë 16.10.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për sa më lart, për sa u përket pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar edhe më parë Gjykatës me ankim kushtetues individual, nëpërmjet të cilit ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të procesit të dytë gjyqësor të zhvilluar ndaj, atij të rishikimit të parë, duke ngritur pretendime edhe për procesin e parë të zhvilluar ndaj tij, atë të themelit. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 236/2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Sipas Kolegjit të Gjykatës, në lidhje me pretendimet për procesin e parë, atë të themelit, kërkuesi nuk

legjitimohej, pasi kërkesa ishte paraqitur haptazi jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që kishte përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar mbante datën 24.02.2014, ndërsa kërkuesi i ishte drejtuar Gjykatës në datën 07.08.2024. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjetra të kërkuesit, të ngritura për procesin e dytë, atë të rishikimit, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial lidhur me të drejtën e ankimit, së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji i Gjykatës i ka vlerësuar ato si haptazi të pabazuara.

23. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet e mësipërme të kërkuesit lidhur me procesin e parë, atë të themelit, ku është vendosur dënimi i tij, janë bërë objekt gjykimi kushtetues edhe më parë, ku ai ka marrë përgjigje të arsyetuar për to, Kolegji vlerëson se ato nuk mund të bëhen më objekt shqyrtimi.

24. Për sa i përket shkakut të rishikimit, mbi të cilin është vënë në lëvizje ky gjykim kushtetues, ai ka të bëjë me parashikimet e nenit 450 të KPP-së. Sipas kërkuesit, gjykatat në arsyetimet e tyre kanë bërë një interpretim formalist të kësaj dispozite, si pasojë e të cilit atij i është mohuar e drejta për rishikim. Po sipas kërkuesit, atij nuk i është respektuar garancia e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor dhe kërkesat e tij për rishikim janë trajtuar në mënyrë formale.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se gjatë zbatimit të ligjit, në ushtrim të funksionit të tyre, gjykatat shfaqen edhe si interpretueset e para të normës ligjore (*shih vendimin nr. 45, datë 11.06.2024*) dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i atyre gjykatave dhe, për më tepër, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 2, datë 14.01.2026; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, gjykatat e zakonshme, veçanërisht Gjykata e Lartë, duhet të interpretojnë parashikimet ligjore në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjvënësit për të garantuar zhvillimin e një procesi të drejtë, si dhe respektimin dhe garantimin e të drejtave kushtetuese të individit. Ndërsa ka pohuar se interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë, Gjykata ka theksuar se kur interpretimi dhe zbatimi i ligjit në një çështje konkrete cenon parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese, atëherë edhe ky interpretim i nënshtrohet kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 2, datë 14.01.2026; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa më lart, në rastin e kërkuesit Kolegji konstaton se gjykatat, vendimet e të cilave janë objekt i këtij gjykimi kushtetues, janë vënë në lëvizje mbi bazën e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 00-2014-1115 (48), datë 24.02.2014 të Kolegjit

Penal të Gjykatës së Lartë. Si shkak për rishikim kërkuesi ka parashtruar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për të njëjtat fakte identike që ka dënuar atë, ka deklaruar të pafajshëm dy të bashkëpandehur. Po ashtu, në kërkesën për rishikim kërkuesi ka ngritur pretendime edhe në lidhje me gjykimin e tij në mungesë.

27. Kërkesa e kërkuesit është rrëzuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit me arsyetimin se nuk plotësohej kushti thelbësor për pranimin e kërkesës për rishikim, konkretisht ekzistenca e dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat bazohen mbi fakte të ndryshme dhe të papajtueshme me njëri-tjetrin, sipas parashikimit të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 450 të KPP-së, pasi jemi para rastit kur gjykata më e lartë, për të njëjtën çështje, ka arritur në konkluzione dhe vlerësime të ndryshme nga gjykatat e faktit vetëm në lidhje me fajësinë për dy nga të bashkëpandehurit në të njëjtin procedim/gjykim me kërkuesin. Po ashtu, ato gjykata u kanë dhënë përgjigje edhe pretendimeve të tjera kërkuesit për cenimit e procesit të rregullt ligjor, lidhur me procesin e parë të zhvilluar ndaj tij, atë të themelit, ku është vendosur dënimi i tij, duke arsyetuar se nuk janë objekt vlerësimi në kuadër të kërkesës për rishikim dhe se pretendimet për zhvillimin e gjykimit në mungesë janë bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga gjykata që ka shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afati të ankimit dhe kërkesën për rishikimin e vendimit bazuar në shkaqe të tjera ligjore. Këto vendime janë lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për të gjitha pretendimet e tij (*shih paragrafët 12-14 të këtij vendimi*)

28. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi e ka ushtruar mundësinë ligjore që i njeh KPP-ja, për sa i përket kërkesës për rishikimin e vendimit penal, duke u dëgjuar dhe marrë përgjigje të arsyetuar në të gjitha shkallët e gjykimit për shkaqet për të cilat gjykatat kanë vendosur rrëzimin e tyre. Në vlerësimin e argumenteve të kërkuesit në tërësi, gjykatat kanë vepruar brenda kompetencave dhe funksionit të tyre dhe nuk rezultojnë të mos kenë pasqyruar në mënyrë të mjaftueshme argumentet në mbështetje të përfundimit të shprehur në dispozitiv. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se arsyetimi i gjykatave në këtë rast nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, që të vërë në dyshim të drejtën për një gjykim të drejtë dhe vetë thelbin e së drejtës. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor janë haptazi të pabazuara.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “dh” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.